



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:905322  
Datë: 17.08.2021  
Numri i dokumentit: 02092184

Ac.nr.2437/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi - kryetar i kolegjit, Rrustem Thaqi dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, me zyrtaren ligjore Biondina Zeneli në çështjen juridike - kontestimore të paditëses E.J. nga Fushë Kosova, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor N.J., të cilin me autorizim e përfaqëson, J.M., avokat nga Fushë Kosova kundër të paditurës Komuna e Fushë Kosovës –Drejtoria për Arsim dhe Shkencë, të cilën me autorizim e përfaqëson Hasime Qyqalla, për kompensim dëmi, vlera e kontestit 40,124.00 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses dhe ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2835/13, i datës 10.01.2018 seancën jo publike, të mbajtur me datë 04.08.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses: E.J. nga Fushë Kosova, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor N.J., dhe ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Komuna e Fushë Kosovës –Drejtoria për Arsim dhe Shkencë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2835/13, i datës 10.01.2018, në pikën I, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material: për shpenzimet për ushqim të përforcuar dhe për kujdesin nga ana e personit të tretë, pika II e dispozitivit të aktgjykimit për pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, si dhe pika III, e dispozitivit lidhur me shpenzimet e procedurës, VËRTETOHET.

II. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Komuna e Fushë Kosovës –Drejtoria për Arsim dhe Shkencë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2835/13, i datës 10.01.2018, në pikën I, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me dëmin jo material dhe gjykohet : DETYROHET e paditura që paditëses në emër të dëmit jo material t’ia paguaj shumat si në vijim: -në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike shumë prej 1,600 euro; - në emër të frikës shumë prej 1,300 euro; si dhe -në emër të shëmtimit shumë prej 1,200 euro,

dhe pika III e dispozitivit të aktgjykimit lidhur me kamatën ashtu që tani gjykohet: DETYROHET e paditura Komuna e Fushë Kosovës –Drejtoria për Arsim dhe Shkencë, që paditëses shumat e gjykuara sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ndryshuar t' ia paguajë kamatën në lartësinë të cilën e paguajnë bankat si për mjetet e afatizuara mbi një vit, duke filluar nga data 10.01.2018 (data e marrjes së aktgjykimit), në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2835/13, i datës 10.01.2018, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që: I.APROVOHET PJESËRISHT si E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses E.J. nga Fushë Kosova, DETYROHET e paditura Komuna e Fushë Kosovës që paditëses në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga djegia në oborrin e shkollës më datë 23.11.2011, t' ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë: Dëmin jo material:-kompensim në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej 3,500.00, -kompensim në emër të frikës, shumën prej 2,500.00, - kompensim në emër të shëmtimit, shumën prej 3,000.00; Dëmin material: -kompensimin për shpenzimet për ushqim të përforcuar shumën prej 250.00, - kompensimi për kujdesin e nga ana e personit të trete shumen prej 300.00. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që: II.REFUZOHET si E PABAZUAR pjesa e kërkesëpadisë përtej shumave nga pjesa e parë e dispozitivit këtu aktgjykimi dhe atë në emër të kompensimit të dëmi jo material për dhimbje fizike shumën prej 6,500.00euro, në emër të frikës 7,500.00, në emër zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 5,000.00, në emër të shëmtimit shumën prej 12,000.00, në emër të dëmit material për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë shumën prej 390.00 dhe shpenzimet e mjekimit në shumë prej 300.00 euro. Në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur që: III.DETYROHET e paditura Komuna e Fushë Kosovës që paditëses shumat e gjykuara në pjesën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi t' ia paguaj edhe kamatën, në lartësinë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara mbi një vit, duke filluar nga data 28.10.2013 si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,318.00, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë paraqitur:

-Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të ligjit materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e parashtruar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që aprovet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe të obligohet e paditura që ti paguaj pjesën e refuzuar nga shkalla e parë.

-Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike me propozim që gjykata e apelit ta kthej në rishqyrtim apo të ndryshohet aktgjykimi i atakuar posaçërisht në pikën I dhe III të aktgjykimit, ashtu që të zvogëlohen shumat për pagesën për dëmin jo material dhe në pikën II kamata që nga viti 2013 e deri e cila nuk vjen me fajin e Komunës së Fushë Kosovës por me vonesën e Gjykatës për shqyrtimin e çështjes.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur nga palët në këtë çështje kontestimore,

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses dhe të paditurës lidhur me pjesët sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi janë të pa bazuara, ndërsa ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës është pjesërisht e bazuar për pjesën si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të tij, me datë 28.10.2013 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2835/13, i datës 10.01.2018, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Gjykata ka vendosur që paditëses t'ia aprovoj pjesërisht kërkesën për dëmin jo material dhe material si në pjesën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke marr për bazë intensitetin e dhimbjeve fizike që në fillim kanë qenë të intensitetit posaçërisht të lartë e të cilat kanë zgjatur për pesë minuta, për të vazhduar më vonë me intensitet të lartë edhe për dy orë dhe me intensitet të mesëm edhe për dy javë të tjera, dhimbje këto të cilat paditësja i ka ndjerë me intensitet të ulët edhe për gjatë një viti. në bazë të kohëzgjatjes së dhimbjeve fizike ka vlerësuar se shuma e gjykuar prej 3,500.00€, paraqet satisfaksion të arsyeshëm për dhimbjet e përjetuara nga paditësja si pasojë e këtij lëndimi. Gjykata e ka vlerësuar si të drejtë dhe objektiv mendimin e ekspertit të psikiatrisë edhe përkitazi me intensitetin e frikës që fillimisht ka qenë e intensitetit primar në kohëzgjatje prej disa sekondash, për të kaluar pastaj në frikë sekondare të intensitetit të lartë për së paku dy javë sa ka zgjatur trajtimi mjekësor dhe intervenimi kirurgjik dhe e Cila pastaj është cilësuar si frikë e intensitetit të ulët për dy muaj të tjerë dhe ka vendosur që si kompensim për frikën e përjetuar nga paditësja t' ia gjykoj shumën prej 2,500.00 euro si kompensim adekuat.

Lidhur me shëmtimin e pamjes fizike të dëmtuarës gjykata e ka gjykuar shumën prej 3,000.00€, duke u bazuar në mendimin e ekspertëve të lartcekur, ku- përmes ekspertizës është konstatuar se paditëses i është shkaktuar shëmtim pamjes fizike në pjesën e këmbës së majtë, ku ka qenë i lokalizuar lëndimi, pasi që aty kanë ngelur vrragët e dukshme të djegies, që do të mbesin si të tilla gjatë gjithë jetës, e të cilat nuk mund te rigjenerohen plotësisht por vetëm pjesërisht. . Gjykata ka vendosur që ta pranoj kërkesëpadinë për ushqimin e përforcuar për paditësen në shumë prej 250€, aq sa është kërkuar me padi, duke u bazuar në kohëzgjatjen e trajtimit mjekësor dhe nevojës për ushqime specifike në kohëzgjatje prej një muaji. Duke u bazuar në mendimin e ekspertëve së paditësja ka pas nevojë për ndihmën dhe kujdesin e vazhdueshëm nga ana e prindërve të saj për së paku një muaj, ka vendosur që t'ia caktoj kompensimin prej 300.00€, duke pasur parasysh faktin së ajo ka qenë fëmijë, se e ka pasur të lënduar shputën e këmbës së majtë që e ka penguar në ecje dhe aktivitete të tjera.

Me rastin e vendosjes si pjesën e parë të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarin-paditësen, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e shëndetit dhe funksioneve jetësore të paditëses.

Po ashtu gjykata mori parasysh, dhimbjet e pësuar fizike, intensitetin e dhimbjeve dhe kohëzgjatjen e tyre, intensitetin e frikës, kohëzgjatjen dhe si është manifestuar për paditësen, duke i marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit sidomos moshën e paditëses si dhe rrethanat dhe vendin ku është lënduar, kur dihet se ambienti ku qëndrojnë fëmijët sidomos institucioni shkollor duhet të ofroj siguri për fëmijët e në rastin konkret është marr për bazë përgjegjësia (papërgjegjësia) e institucionit në ambientet e shkollës

ku nxënësit frekuentojnë siç është oborri i shkollës, praktikën e mirë gjyqësore (që i referohet lartësisë së kompensimit) Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë për kompensimin e dëmit, gjykata me kërkesën e të autorizuarit të paditëses dhe në bazë të nenit 277 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e detyroi të paditurën që paditëses në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën siç i paguajnë bankat për mjetet të afatizuara mbi 12 muaj, duke filluar nga data e dorëzimit të padisë në gjykatë, deri në pagesën definitive.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditëses edhe atë për dhembje fizike shumë prej 6,500.00€, për frikën e pësuar shumë prej si dhe për shëmtim shumë prej 12,000.00, gjykata vendosi pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur edhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejtë dhe se lartësia e kërkesës për këtë Lloj të dëmit është e lartë dhe në kundërshtim me provat e administruara, kjo gjykatë vendimin e vet e bazoi në mbështetje të ekspertizës së ekspertëve mjekësor, provat e dorëzuara, kriterëve dhe masat për caktimin e dëmeve.

Po ashtu gjykata e refuzoi kërkesën në padi për dëmin material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, pasi sipas mendimit të ekspertëve të paditësja nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, sepse lëndimet e shkaktuara nuk do të ndikojnë në të ardhmen në ushtrimin normal të çfarëdo aktiviteti jetësor.

Gjykata ka vendosur për refuzimin e pjesërishëm të kërkesës për dëmin material edhe atë sa i përket ndihmës nga personi i tretë në shumë prej 390.00€, ngase paditësja nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi në emër të pagave të humbura nga përfaqësuesja e saj ligjore-nëna e Cila është kujdesur gjatë periudhës së trajtimit nga lëndimet e pësuar. Gjithashtu sa i përket shpenzimeve të shërimit kjo kërkesë u refuzuar e pa bazë, pasi që sipas provave të administruara e paditura në dy raste me vendim të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, paditëses ia ka paguar shpenzimet e shërimit në lartësi prej 900.00€ andaj në mungesë të dëshmive për dëmin e pretenduar material, sipas kësaj baze, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar në këtë mënyrë gjendjen faktike, me prova materiale e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 323 të LPK-së lidhur me nenin 154, 170,190 e 200 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensoj shumat si në pjesën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi në emër të dëmit jo material dhe material. Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë shumë prej 208.00 €, për ekspertizat mjekësore shumë prej 200.00€, për tri përfaqësime në seanca nga 270,00 € gjithsej tri përfaqësime në seanca shumë prej 820.00€, taksën gjyqësore në shume prej 100€.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditëse se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me

peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore e autorizuarit të paditurës për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se paditësja me datën 23.11.2012 deri sa ka qenë nxënëse e klasës së parë në Shkollën Filllore “Daut Bogujevci” në Fushë Kosovë, gjatë pushimit në mes të orëve la dalë në oborrin e shkollës së bashku me nxënësit e tjerë dhe gjatë lojës në oborr ka shkelë në një grumbull prushi të mbuluar me hi, të hedhur paraprakisht nga punëtorët kujdestar të shkollës me ç’ rast ka pësuar djegie të shkallës së tretë në shputën e këmbës dhe pastaj është dërguar për shërim në QKUK në Prishtinë ku ka qëndruar deri me datën 09.12.2012, dhe paditësja i është nënshkruar operacionit plastik në regjionin e shputës së këmbës së majtë. Të gjitha këto rrethana nuk janë kundërshtuar këtu nga palët.

Lidhur me pretendimet e palës së autorizuar të paditëses se gjykata është lëshuar vetëm në vlerësimin e ekspertëve mjekësor, dhe se të njëjtit kanë qenë kontradiktor, kjo Gjykatë konsideron se pala paditëse e ka pasur mundësinë që të kundërshtoj ekspertizën në fjalë, madje ka pasur mundësinë edhe që të kërkojë të caktohen ekspertë të tjerë në qoftë se nuk është pajtuar me ekspertizën në fjalë. Ndërsa lidhur me pretendimin se gjykata është lëshuar vetëm në vlerësimin e ekspertëve kjo nuk qëndron sepse gjykata e shkallës së parë ka administruar të gjitha provat që i janë paraqitur të njëjtës dhe në bazë të tyre ka provuar secilin fakt veç e veç e të gjitha së bashku, ndërsa ekspertiza ka qenë e nevojshme që gjykata të sqarojë faktet për rrethanat për të cilat ka qenë e nevojshme dija profesionale e mjekëve e të cilën nuk e ka pasur gjyqtari i çështjes. Andaj, lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit material për kompensimin e shpenzimeve për ushqim të përforcuar dhe kompensim për kujdesin nga ana e personit të tretë, është në harmoni me rrethanat e tjera të krijuara si dhe edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se ka qenë e nevojshme përkujdesja e personit tjetër në kohëzgjatje prej 1 muaj, në kuptim të ndihmës të aktiviteteve të përditshme jetësore, kështu që Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe drejtë ka vendosur lidhur me kompensimin e dëmit material.

Por, kjo Gjykatë konsideron se qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurës lidhur me vërtetimin jo të plotë dhe të gabueshëm të gjendjes faktike vetëm lidhur me dëmin jo material, për faktin se Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar nuk përkojnë me shkallën e lëndimit të paditëses, dhe meqenëse vetë gjykata e shkallës së parë i ka falur besimin ekspertizës së ekspertëve nga fusha e mjekësisë të cilët e kanë cilësuar si lëndim të lehtë trupor, shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar sipas Gjykatës së Apelit janë të larta në raport me lëndimet e shkaktuara. Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për kategoritë e dëmit jo material dhe atë: për dhembjet fizike, frikën e përjetuar dhe shëmtimin pasi që vlerësoj se shumat e gjykuara nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërbejnë kompensimit dhe në përputhje me ndarjen e përgjegjësisë. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin. Mbi këtë bazë Gjykata e Apelit duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësja, llojin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika te paditësja si dhe rrethanat tjera, si moshën e paditësit dhe praktikën e mirë

gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 200 të LMD-së, vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi është ndryshuar sa i përket kamatës sepse gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjkata e Apelit ka vendosur si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e duke iu referuar nenit 277 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 21.11.2016, e deri në pagesën definitive, sepse pala paditëse për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Gjkata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe nuk kanë ndikim për vendimmarrje ndryshe nga ai sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Ac.nr.2437/18, me datë 04.08.2021

Kryetari i kolegjit  
Faton Ademi